



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 7 korrik 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni – kryetar, Gani Geci, Adem Hajdaraj, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Radmila Vujović, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Selviqe Halimi, Kolë Berisha dhe Mufera Şinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu – ICO, Adriana Çeta – ICO, Petrit Hysaj – OSBE, Isuf Zejna – KDI dhe Albulena Ademi – praktikante.

Nga stafi i Komisionit: Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 23 dhe të 28 qershorit 2010,
3. Shqyrtimi në parim i projektligjeve: P/L për Prokurorin e Shtetit, P/L për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe P/L për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në P/L për konfliktet administrative, në P/L për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës dhe në P/L për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë të Kosovës,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 23 dhe të 28 qershorit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e 23 dhe të 28 qershorit 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i projektligjeve: P/L për Prokurorin e Shtetit, P/L për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe P/L për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës

Kryetari - I njoftoi të pranishmit se i kemi në shqyrtim në parim tri P/L para se të dërgohen për lexim të parë. Në vazhdim tha se P/L për Prokurorin e Shtetit dhe P/L për Këshillin Prokurorial të Kosovës janë hartuar mirë dhe duhet të dërgohen për shqyrtim në lexim të parë. Kishte vërejtje në P/L për Këshillin Gjyqësor, sepse nuk ishte i hartuar mirë. Kërkoj nga anëtarët të deklarohen që P/L të dërgohet për shqyrtim në lexim të parë, edhe pse do të ketë punë gjatë amendamentimit të tij.

Ibrahim Makolli - Do të ishte mirë ta kalojmë edhe P/L për Këshillin Gjyqësor, edhe pse nuk është i hartuar mirë. Kjo është edhe kërkesë e Komisionit Evropian. Edhe pse do të kishte punë në grupet e punës, ishte i mendimit të dërgohet për lexim të parë.

Ramadan Gashi - P/L për Këshillin Gjyqësor e ka një përkthim shumë të dobët, mirëpo në përmbajtje nuk ka shumë defekte të mëdha. Ishte i mendimit se duhet të dërgohet për shqyrtim të mëtejshëm, ngase në grupet e punës mund të përmirësohet.

Selvi Halimi - U pajtua me parafolësit se duhet të dërgohet tutje, edhe pse do të kemi shumë punë, ngase duhet të rregullohet edhe teknikisht, edhe në përmbajtje. Shkak për këtë e përmendi mungesën e përkthimeve profesionale, të cilat po ia humbin përmbajtjen ligjit.

Radmilla Vujović – Duke folur për P/L për Këshillin Gjyqësor tha se në hartimin e ligjeve duhet të marrin pjesë ekspertë të profileve përkatëse, sepse në mungesë të tyre i kemi këto përkthime kaq të dobëta, për të cilat folën edhe anëtarët e tjerë.

Gani Geci - Ishte i mendimit se grupi i punës do të ketë punë, sepse, nëse duhet të bëjmë amendament për secilin nen, do të na dalin më shumë amendamente sesa nene.

Pas diskutimeve, që u zhvilluan, Komisioni i miratoi në parim P/L për Prokurorin e Shtetit, P/L për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe P/L për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, për t'u proceduar për lexim të parë në seancën e radhës.

4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në P/L për konfliktet administrative, në P/L për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës dhe në P/L për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë të Kosovës

Kryetari i paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media. Pati vërejtje në amendamentet 1, 2, 4 dhe 23, si dhe për mospërfshirjen e referencave në nenet përkatëse.

Meqë pati vërejtje për propozimamendamentet në P/L për konfliktet administrative, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi i shqyrtoi propozimamendamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe i paraqiti vërejtjet:

- Komisioni sugjeron të rishikohen amendamentet 1 (një) “Objekti i ligjit” dhe 2 (dy) “Qëllimi i ligjit”, sepse këto dy nene kanë të njëjtën përmbajtje.
- Amendamenti 5 (pesë), të rishikohet fjala “përfundimtare”, sepse duhet të qartësohet cilat akte janë përfundimtare.
- Amendamenti 6 (gjashtë), ka vërejtje për mospërfshirjen e referencave të neneve, dhe se është e panevojshme përfshirja e parimeve në këtë ligj.
- Amendamentet 7, 24, 25, 26 dhe 27 janë çështje që kanë të bëjnë me organizimin e gjykatave.

Komisioni pati vërejtje edhe për propozimamendamentet e P/L për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës dhe lidhur me këtë, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

I. Komisioni sugjeron që amendamentet 1 (një) dhe 2 (dy) të harmonizohen ndërmjet tyre, sepse janë në kundërshtim njëri me tjetrin, ngase për të njëjtin nen janë dhënë dy propozime nga Komisioni FunkSIONAL, gjë që e komplikon radhitjen, siç është propozuar.

II. Komisioni ka vërejtje për mospërfshirjen e referencave të neneve dhe ka dilema se cili autoritet do t'i vendosë ato nene. Kjo ka të bëjë me dispozitat themelore, me amendamentet 4 dhe 23.

III. Komisioni kërkon të sqarohet amendamenti 21, përkatësisht riformulimi se kompetencë e kujt është nxjerrja e urdhëresave, sidomos te përfshirja e drejtorëve.

Kryetari i paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës në P/L për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kishin vërejtje eventuale.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

I. Projektligji për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë të Kosovës nr. L-213 dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional e kanë bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për tim në seancën plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni